



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

---

**Informacion mbi aktivitetin e planifikuar në projektin:  
“Interpretimi/përkthimi në realitetin virtual. Integrimi i teknologjisë në procesin e përkthimit”**

**Aktiviteti: Interpretimi përmes platformës ZOOM**

**Trajnimi u organizua nga Prof.as.dr. Jonida Gjuzi dhe Dr. Migena Sejдини**

Në datë 26 tetor 2023 në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në laboratorin e teknologjisë, u organizua aktiviteti me temë “Interpretimi përmes platformës ZOOM”, ku morën pjesë studentë që ndjekin studimet e ciklit të dytë në drejtimin “Përkthim dhe interpretim”.

Qëllimi i aktivitetit ishte njohja e studentëve me mundësitë që të ofrojnë platformat online për të zhvilluar interpretim simultan në distancë specifiku për platforma Zoom.

Në pjesën e parë të aktivitetit studentët u njohën me interpretimin si pjesë së translato-logjisë, llojet e interpretimit dhe karakteristikat e përgjithshme të tyre. U diskutua mbi kompetencat e interpretit dhe rëndësinë e secilës prej tyre gjatë ushtrimit të këtij profesioni.

Faza e dytë u fokusua te veçoritë që karakterizojnë interpretimin simultan dhe puna përgatitore që duhet të bëjë një interpret para se të nis punën. Studentët u njohën me platformën online ZOOM, karakteristikat, mënyrën e përdorimit të saj si dhe shërbimet që ajo i ofron një interpreti për të zhvilluar interpretimin simultan online dhe çfarë duhet të mbaj në vëmendje në kushte të tilla pune.

Në pjesën e fundit të aktivitetit studentët patën mundësinë të provonin konkretisht se si funksiononte interpretimi simultan përmes Zoom-it duke bërë dhe eksperiencat e para me këtë mënyrë aktuale të përkthimit. Në përfundim të aktivitetit u diskutuar mbi eksperiencën e përfutur.



